



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Zyra e Kryetarit
Nr. 19/ 2024
Datë: 19.012.2024

PËR/ZA/TO:	- Edona Kameraj- Zyra për Informim
CC:	Z. Bashkim Ramosaj- Kryetar i komunës
NGA/OD/FROM:	Ajne Iberhysaj- Ushtruese Detyrë për Barazi Gjinore
TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT:	Procesverbal

Procesverbal nga takimi për draft-strategjinë kundër dhunës në familje në Komunën e Deçanit
Data: 19 dhjetor 2024

Vendi: Komuna e Deçanit

Udhëheqëse e takimit: Ajne Iberhysaj – Koordinatore kundër dhunës në familje dhe ushtruese detyre e zyrtares për barazi gjinore. Më 19 dhjetor 2024, në Komunën e Deçanit u mbajt takimi për shqyrtimin e draft-strategjisë kundër dhunës në familje për periudhën 2024–2027.

Takimi u udhëhoq nga znj. Ajne Iberhysaj, e cila njëkohësisht ushtron detyrën e zyrtares për barazi gjinore. Në këtë takim, znj. Iberhysaj bëri prezantimin e draft-strategjisë dhe Planit të Veprimit për parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje, duke theksuar rëndësinë e këtij dokumenti për garantimin e një qasjeje të koordinuar ndërinstitucionale në këtë fushë.

Gjatë diskutimit, pjesëmarrësit shtruan pyetje lidhur me ndarjen e mjeteve buxhetore për realizimin e aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit. U theksua rëndësia që Komuna e Deçanit, duke u pajisur me këtë strategji dhe plan, të parashohë mjete të veçanta gjatë planifikimit buxhetor për mbështetjen e aktiviteteve që promovojnë barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës në familje. Në përmbyllje të takimit, u dhanë disa rekomandime nga pjesëmarrësit dhe u ra dakord që draft-strategjia dhe plani shoqërues të procedohen për miratim në Kuvendin Komunal të Deçanit.

Pjesëmarrës në takim: Gjithsej: 22 persona (16 gra dhe 6 burra)

Procesverbalin e përgatiti: Ajne Iberhysaj

